

Vendim nr. 30 datë 13.02.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Holta Zaçaj,	Anëtare

në datën 13.02.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ANDRI YMERI

OBJEKTI: Konstatimin e shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në standardin kushtetues “gjykatë e krijuar me ligj”, për shkak të papajtueshmërisë për ushtrimin e funksionit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të shtetasve G.B., F.SH., P.Q., B.B., S.ZH. dhe A.F.

Shfuqizimin pjesërisht të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 82/2017 “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për sa u përket të zgjedhurve në institucionet e rivlerësimit, të komisionerëve G.B., F.SH., P.Q., B.B., S.ZH. dhe A.F.

Marrjen e masës së përkohshme të pezullimit të vijimit të shqyrtimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarit Andri Ymeri deri në zgjidhjen e konfliktit gjyqësor me vendim përfundimtar të formës së prerë.

Përcaktimi nga Gjykata Kushtetuese, përmes pjesës arsyetuese dhe urdhëruese të vendimit të saj, të faktit se cili organ

shtetëror ka juridiksion dhe/apo kompetencë ligjore për të shqyrtuar çështjen në themelin e saj, duke pasur parasysh edhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen Besnik Cani kundër Shqipërisë dhe Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 15, 17, 42, pika 2, 131 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 45, 49, pika 3, 51, 54, 56, 71, 71/a, 72 dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Andri Ymeri ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe për këtë shkak, i është nënshtruar rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në kuptim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës.

2. Në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 84/2016*) dhe rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*KPK*) ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët P.Q., R.I. dhe E.Ç.

3. Pas njohjes me rezultatet e hetimit vetëm mbi kriterin e pasurisë, të dërguara në datën 19.04.2022, dhe paraqitjes së shpjegimeve shoqëruar me prova, subjekti i rivlerësimit (kërkuesi) është ftuar në seancë dëgjimore në datën 13.06.2022, në të cilën ka kërkuar përjashtimin nga trupi gjykues të komisionerëve R.I. dhe E.Ç. Për shqyrtimin e kërkesave për përjashtim janë

caktuar me short trupat gjykues, të cilët, me vendimet e datave 15.06.2022 dhe 17.06.2022, kanë vendosur pranimin e tyre. Për rrjedhojë, me vendimet nr. 22 dhe nr. 23, datë 17.06.2022 të KPK-së janë caktuar me short anëtarët e rinj të trupit gjykues, G.T. dhe F.SH. Kërkuesi është njoftuar nëpërmjet postës elektronike për këtë ndryshim të trupit gjykues.

4. Trupi gjykues i KPK-së, me vendimin nr. 5, datë 21.06.2022, ka vendosur riçeljen e hetimit administrativ për subjektin Andri Ymeri dhe vijimin e hetimit për të tria kriteret e vlerësimit, duke filluar procesin e rivlerësimit dhe hetimin e thelluar administrativ.

5. Për çështjen e kërkuesit trupi gjykues i KPK-së ka zhvilluar seanca dëgjimore në datat 09.12.2022, 12.12.2022, 13.12.2022, 14.12.2022 dhe 19.12.2022.

6. Në seancën e datës 09.12.2022 kërkuesi ka kërkuar përjashtimin e dy anëtarëve të trupit gjykues, komisionerëve F.SH. dhe P.Q. Këto kërkesa janë marrë në shqyrtim nga trupat gjykues të zgjedhur me short, të cilët, me vendimet e datës 09.12.2022, kanë vendosur mospranimin e tyre si të pabazuara në prova dhe në ligj. Në seancën e datës 12.12.2022 kërkuesi ka paraqitur kërkesa për përjashtimin e të tre anëtarëve të trupit gjykues, të cilat janë rrëzuar me vendimet e datave 12.12.2022 dhe 15.12.2022 të trupave gjykues të zgjedhur me short për këtë qëllim. Në seancën e datës 13.12.2022 subjekti ka paraqitur sërish kërkesë për përjashtimin e të tre anëtarëve të trupit gjykues, për të cilat, trupi gjykues i zgjedhur me short, me vendimin e datës 16.12.2022 ka vendosur mospranimin.

7. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 14.12.2022 kërkuesi ka kërkuar kohë për të përgatitur konkluzionet përfundimtare, për rrjedhojë seanca e radhës është caktuar në datën 19.12.2022. Në atë seancë përfaqësuesi i kërkuesit ka kërkuar të paraqesë dy kërkesa të tjera për përjashtim, një për anëtarin e trupit gjykues G.T. dhe një për të gjithë anëtarët, kërkesa që trupi gjykues ka vendosur të mos i administrojë, duke i konsideruar si abuzive dhe duke vlerësuar se kanë qëllim të vetëm zvarritjen dhe pengimin e procesit. Seanca për shpalljen e vendimit të KPK-së është caktuar në datën 21.12.2022.

8. Me kërkesën e datës 20.12.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt, në drejtim të standardit të gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj, për shkak të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të anëtarëve të trupit gjykues të KPK-së. Ai ka kërkuar, gjithashtu, shfuqizimin pjesërisht të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*) nr. 82/2017 për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, vetëm në lidhje me komisionerët

e KPK-së që kanë marrë pjesë në trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen e tij, si dhe të atyre që kanë marrë pjesë në trupat gjykues që kanë shqyrtuar kërkesat për përjashtim.

9. Ankimi kushtetues individual, pas plotësimit nga kërkuesi me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në Gjykatë me nr. 4 (A) 2023, datë 18.01.2023.

10. Në lidhje me procesin e rivlerësimit kalimtar të kërkuesit, me vendimin nr. 604, datë 21.12.2022, KPK-ja ka vendosur: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.”*. Në vlerësimin e komisionit, subjekti i rivlerësimit: ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale; nga vlerësimi tërësor, në kuptim të pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. **Kërkuesi** ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt gjatë procesit të zhvilluar në KPK, në drejtim të standardit kushtetues të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe:

11.1. Komisionerët e KPK-së, që kanë marrë pjesë në trupin gjykues të caktuar për të gjykuar çështjen e kërkuesit nuk plotësojnë kërkesat ligjore të zgjedhshmërisë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 6 të ligjit nr. 84/2016, duke mos u respektuar standardi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Për këtë shkak, në seancat dëgjimore në KPK janë paraqitur kërkesa të vazhdueshme për përjashtimin e tyre, të cilat janë shqyrtuar nga trupa të tjerë të atij organi dhe janë rrëzuar me arsyetimin se ata nuk kanë kompetencë të vendosin për kushtet e zgjedhshmërisë së komisionerëve të KPK-së, të caktuar në detyrë me vendim të Kuvendit.

11.2. Duke qenë se KPK-ja ka refuzuar t'u japë përgjigje kërtimeve të parashtruara nga kërkuesi, ai i është drejtuar Gjykatës për rivendosjen e të drejtave të cenuara, çka mund të realizohet duke shfuqizuar pjesërisht vendimin nr. 82/2017 të Kuvendit, për zgjedhjen e këtyre komisionerëve si anëtarë të KPK-së. Cenimi i procesit të

rregullt mund të parandalohet nga Gjykata vetëm duke vendosur pezullimin e procesit të rivlerësimit derisa sa ajo të shprehet me vendim përfundimtar.

- 11.3. Në kushtet kur Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka gjetur shkelje të standardit të gjyqimit nga një gjykatë e caktuar me ligj në çështjet Besnik Cani kundër Shqipërisë dhe Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë, në mbështetje të neneve 54 dhe 56 të ligjit nr. 8577/2000, në zbatim të detyrimeve që i janë ngarkuar shtetit shqiptar në këto vendime, nëse Gjykata vlerëson se nuk mund ta trajtojë në themel çështjen, duhet të përcaktojë organin shtetëror që duhet të bëjë një gjë të tillë. Kjo edhe me qëllim garantimin e së drejtës së ankimit efektiv, të parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

12. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

13. Kjo kompetencë kushtetuese e Gjykatës është reflektuar dhe detajuar në nenin 71 të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, ka të drejtë të kundërshtojë para saj çdo akt që cenon këto të drejta dhe liri, sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji. Në këndvështrim të kësaj kompetence, Gjykata vlerëson kërkesat e individit kur ai pretendon se të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese janë cenuar nga një akt i pushtetit publik ose vendim gjyqësor.

14. Referuar objektit të kërkesës në shqyrtim, kërkuesi ka ngritur disa kërkime para Gjykatës. Ai ka kërkuar konstatimin e shkeljes së të drejtës për proces të rregullt, në drejtim të standardit kushtetues “gjykatë e krijuar me ligj”, për shkak të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit nga anëtarët e KPK-së që kanë marrë pjesë në trupin gjykues të caktuar për të shqyrtuar çështjen e tij dhe në trupat gjykues që kanë shqyrtuar kërkesat për përjashtim. Ai ka kërkuar edhe shfuqizimin pjesërisht të vendimit nr. 82/2017 të Kuvendit për miratimin e listës në

bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, vetëm për sa u përket këtyre komisionerëve. Duke vlerësuar se rivendosja e të drejtave të tij mund të realizohet vetëm nëpërmjet pezullimit të procesit të rivlerësimit në KPK, kërkuesi ka kërkuar edhe marrjen e masës së përkohshme të pezullimit të këtij procesi deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata. Nga ana tjetër, në vijim të vendimeve të GJEDNJ-së që kanë gjetur shkelje të këtij standardi kushtetues në procesin e rivlerësimit, kërkuesi ka kërkuar që Gjykata të përcaktojë, përmes pjesës arsyetuese dhe urdhëruese të vendimit të saj, organin shtetëror që ka juridiksion dhe/ose kompetencë për të shqyrtuar këtë çështje në themelin e saj.

15. Kolegji vëren se vendimi i Kuvendit i kundërshtuar nga kërkuesi është akt i pushtetit publik i natyrës individuale, me anë të të cilit Kuvendi ka shprehur vullnetin e tij për krijimin dhe formësimin e organeve kushtetuese të rivlerësimit kalimtar. Megjithatë, pretendimet e kërkuesit në thelbin e tyre janë orientuar në drejtim të së drejtës për proces të rregullt gjatë procesit të zhvilluar në KPK, për të cilin, në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë, nuk kishte ende një vendim. Konkretisht, ato kanë të bëjnë me mosrespektimin e standardit kushtetues të gjykatës së caktuar me ligj, në lidhje me përbërjen e trupave gjykues të caktuar për të shqyrtuar çështjen e tij, si dhe kërkesat e ndërmjetme për përjashtim të parashtruara gjatë atij procesi.

16. Kolegji vëren, gjithashtu, se e drejta për proces të rregullt, përfshirë edhe standardin e gjykatës së caktuar me ligj, garantohet gjatë një procesi ligjor ose gjyqësor, në funksion të rezultatit përfundimtar, që sjell pasoja konkrete dhe të drejtpërdrejta për kërkuesit, si bartës të të drejtave kushtetuese procedurale dhe substanciale. Për rrjedhojë, duke qenë se kërkimet e ngritura në kërkesë dhe pretendimet e kërkuesit janë të ndërlidhura, Kolegji nuk e vlerëson të nevojshme që t'i shqyrtojë ato veçmas, për sa kohë që në thelb kanë të bëjnë me të njëjtin proces, atë të rivlerësimit kalimtar të zhvilluar nga KPK-ja, dhe mbështeten mbi të njëjtat shkaqe.

17. Referuar përmbajtjes së nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, Gjykata funksionon me dy kolegje. Neni F, pika 1, i Aneksit të Kushtetutës parashikon se Komisioni i Pavarur i Apelit (KPA) është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të KPK-së, sipas Aneksit dhe ligjit.

18. Juridiksioni i Gjykatës në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual për kontrollin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit është i kufizuar nga juridiksioni që dispozitat e Kushtetutës dhe Aneksit të saj u kanë dhënë organeve të rivlerësimit. Gjykata ka vlerësuar se sipas nenit A të Aneksit të Kushtetutës, me qëllim kryerjen e këtij procesi, kufizohet

edhe neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, çka nënkupton se ky kufizim lidhet specifikisht me të drejtën e subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi për t’iu drejtuar Gjykatës, kurse sipas nenit F, pika 8, po të Aneksit të Kushtetutës, subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në GJEDNJ (*shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, organet e rivlerësimit ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Nga mënyra e cilësimit të KPA-së në Kushtetutë dhe në ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ai mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera (*shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Neni 179/b, pika 2, i Kushtetutës parashikon se procesi i rivlerësimit, që realizohet nga KPK-ja dhe KPA-ja, do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit. Në këtë kuptim, të gjitha të drejtat procedurale kushtetuese, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, përfshirë edhe standardin e gjykatës së caktuar me ligj, Kushtetuta ua ka garantuar subjekteve të rivlerësimit, përmes procesit gjyqësor në KPA. Duke pasur parasysh kompetencat e KPA-së, si organi që kontrollon vendimmarrjen e KPK-së, Gjykata ka vlerësuar se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa më sipër, kërkimet dhe pretendimet e paraqitura nga kërkuesi, që lidhen me respektimin e së drejtës për proces të rregullt në procesin e zhvilluar në KPK, në aspektin e standardit kushtetues të gjykatës së caktuar me ligj, për shkak të mosplotësimit të kriterëve ligjore nga anëtarët e zgjedhur të atij organi, nuk hyjnë në juridiksionin e kësaj Gjykate.

22. Kolegji vlerëson se kërkuesi, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 2, të Aneksit të Kushtetutës, ka të drejtë të ushtrojë ankim në KPA, si organi i vetëm që ka juridiksion të shqyrtojë këto ankime, ku mund të ngrejë të gjitha pretendimet e tij, me natyrë kushtetuese dhe ligjore, për procesin e zhvilluar nga KPK-ja, përfshirë parashtrimin e gjetjeve të GJEDNJ-së në çështje të ngjashme ku palë ka qenë shteti shqiptar. KPA-ja, vendimi i së cilës ka natyrë përfundimtare brenda sistemit të brendshëm të ankimeve, ka detyrimin t’i shqyrtojë pretendimet

e tij me natyrë kushtetuese dhe të garantojë të gjitha të drejtat procedurale kushtetuese, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, përfshirë edhe standardin e gjykatës së caktuar me ligj, të cilat i njihen kërkuarit në cilësinë e subjektit të rivlerësimit. Rrjedhimisht, kërkuari ka në dispozicion mjete kushtetuese dhe ligjore për garantimin e së drejtës për proces të rregullt gjatë procesit të rivlerësimit.

23. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kjo çështje nuk hyn në juridiksionin kushtetues, ndaj kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.